

**N**ë Islam, një ndër gjërat më me vlerë dhe që çon ka një jetë komode dhe e begatë me të mira, pa dyshim është harmonia bashkëshortore. Andaj shfrytëzojmë rastin t'ju japim disa këshilla për të arritur këtë qëllim në mënyrë sa më të lehtë.

### 1. Pranimit i bukur

Pas kthimit nga puna, shkolla, udhëtimi, ose çkado që ju ka ndarë:

- Filloni me një përshëndetje të mirë.
- Filloni me Esselamu Alejkum dhe me buzëqeshje. Selami është sunnet dhe dua për ate në të njëjtën kohë.
- Shtrëngoni duart me te (përshëndetuni me dorë) dhe leni lajmet e këqija për më vonë!

### 2. Të folurit e ëmbël dhe ftesa mahnitëse

- Zgjidhni fjalë të cilat janë pozitive dhe largohuni atyre që janë negative.
- Përkushtoni vemendjen tuaj kur flitni ose kur ajo flet.
- Flitni me qartësi dhe përsëritni fjalët nëse ka nevojë derisa ajo të kupton.

- Thërriteni me emra të mira të cilat i pëlqejnë asaj, p.sh. e dashura ime, loçkë, bukuroshe etj.

### 3. Mirëdashësia dhe rekreimi

- Kaloni kohë duke biseduar sëbashku
- Tregoni asaj lajme të mira
- Përkujtoni çastet e mira që keni kaluar sëbashku.

### 4. Lojëra dhe zbavitje

- Bërja e shakave dhe pasja e ndjenjës për humor.
- Loja ose garimi me njëri tjetrin në sporte ose çkado.
- Dalja për të parë forma të lejuara (halal) të zbavitjes.
- Largimi prej gjërave të ndaluara (haram) si forma të zbavitjes.

### 5. Ndhurma në shtëpi

- Kryerja e asaj pune që ndihmon dhe të cilën ju si individ mundeni/pëlqeni ta kryeni në shtëpi, sidomos kur ajo është e sëmurë ose e lodhur.

- Gjëja më e rëndësishme është të jetë e qartë dhe e dukshme se ai e çmon punën e saj të vyer.

### 6. Konsultimi (shurah)

- Specifikisht në çështjet familjare.
- Dhënia e ndjenjës së mendimit i saj është e rëndësishme për ty.
- Analizimi i mendimit të saj me kujdes.
- Të jeni të gatshëm të ndërroni mendimin tuaj për mendimin e saj nëse është më i mirë.

## Klubi studentor

- Falënderimi për ndihmën që ka dhënë me mendimet e veta.

### 7. Vizitimi i të tjerëve

- Zgjedhja e njerëzve të edukuar dhe të pjekur mirë me të cilët do të ndërtohen marrëdhënie. Ka shpërblim të lartë në vizitimin e kusherinjëve dhe njerëzve të devotshëm. (Jo duke humbur kohë gjatë këtyre vizitave!).

- Të ketë kujdesë për sjellje islame gjatë vizitave.
- Mos ta detyron të vizitohet ata me të cilët nuk ndjehet e rehatshme.

### 8. Sjellja gjatë udhëtimit

- Ofroni lamtumirë të ngrohtë dhe këshilla të mira.

- Le t'i thotë/ kërkon që të lutet për te.
- Kërko prej kusherinjëve të devotshëm dhe shokëve që të kujdesen për familjen gjatë mungesës sate.

- Jepi të holla të mjaftueshme për gjërat për të cilat mund të ketë nevojë.

- Mundohuni që të mbani kontakt me te qoftë me telefon, e-mail, letra, etj.

- Kthehuni sa më shpejt.

- Sjellni një dhuratë për te!

- Tentoni që të mos ktheheni në kohë të papritur ose gjatë natës.

- Merreni me ju nëse është e mundur.

### 9. Mbështetja financiare

- Burri duhet të jetë zemërgjërë brenda mundësive të tija financiare. Ai nuk duhet të jetë koprac me të hollat e tija (por jo edhe shkapërdar).

- Ai fiton shpërblime për të gjitha shpenzimet për mirëmbajtjen e saj madje edhe për një copë të vogël të bukës me të cilën e ushqenë me dorën e vet (hadith).

- Ai me të madhe nxitet që t'i jep asaj para se ajo të kërkon..

### 10. Parfumosja (erërat e mira) dhe zbulurimi fizik

- Praktikimi i sunnetit në largimin e qimeve prej vendeve të turpshme dhe nënsjetullave.

- Gjithmonë të jetë i pastër dhe i rregulluar.

- Të vëndon parfum për te.

### 11. Marrëdhënie (seksuale)

- Është e obligueshme që të kryhet zakonisht (në mënyrë të rëndomtë) nëse nuk keni arësytet (sëmundje etj.).

- Filloni me "Bismil-lah" dhe me du'anë e të Dërguarit [sal-lallahu alejhi ve selem].

- Kryeni hyrjen vetëm në vendin e përshtatshëm (jo në anus).

- Filloni me paralojë duke përfshirë fjalë dashurie.

- Vazhdoni derisa e keni kënaqur/ përmëshur dëshiren e saj.

- Pas kësaj relaksohuni dhe bëni shaka.

- Largohuni marrëdhënieve gjatë menstruacioneve, pasi që është haram.

- Bëni çka mundeni që të mos e dëmtoni nivelin e hajaa-së (turpit dhe modestisë) siç është heqja e teshave sëbashku, në vend se të kërkon që ajo t'i heq e para derisa ai e shikon atë.

- Gjatë marrëdhënies shmanguni prej pozitive të cilat mund të jenë të dëmshme për te, si për shembull, duke shkaktuar shtypje në gjoksin e saj dhe duke bllokuar ajrin e saj, sidomos nëse jeni të rëndë.

- Zgjedhni kohë të përshtatshme për marrëdhënie dhe bëhuni të kuptueshëm pasi që ajo ndonjëherë mund të jetë e sëmurë ose e stërlodhur.

### 12. Mbrojtja e intimitetit (fshehtësive)

- Largohuni prej shpalljes së informatave private siç janë fshehtësirat nga dhoma e fjetjes, problemet e saja personale dhe çështje tjera private.

### 13. Dhënia e ndihmesë në Dëgjueshmërinë ndaj All-llahut [subhanehu ve tealaj]

- Zgjhuni në pjesën e tretë të natës të falni "Kijam ul-Lejl" (namaz nafle që kryhet gjatë natës me suxhud të gjatë dhe ruku'u).

- Mësojani asaj atë që e dini prej Kur'anit dhe tefsirit.

- Mësojani asaj "Dhikrin" (mënyra të ndryshme për ta përkujtuar All-llahun [subhanehu ve tealaj] sipas shembullit të të Dërguarit) në mëngjes dhe në mbrëmje.

- Nxiteni që të harxhon të holla për hir të All-llahut [subhanehu ve tealaj] siç janë sadakatë (lëmosha).

- Merreni në Haxh ose në Umre kur keni mundësi financiare për ta bërë këtë.

### 14. Tregimi i respektit ndaj Familjes së saj dhe shokëve

- Merreni që ta viziton familjen e saj dhe kushërinjët, e sidomos prindërit e saj.

- Ftoni ata që ta vizitohet atë dhe mirëpritni.

- Jepjuni dhurata në raste të veçanta.

- Ndhmoni kur ka nevojë me të holla, mund, etj..

- Mbani marrëdhënie të mira me familjen e saj mbas vdekjes së saj nëse ajo vdes e para. Poashtu në këtë rast burri nxitet që të vepron sipas sunnetit të dhe të vazhdon të jep prej asaj që ajo ka dhanë gjatë jetës së saj shoqeve të saja dhe familjes.

### 15. Stërvitja dhe këshillimi (Islam)

Kjo përmbanë:

- Themelet e islamit

- Detyrat dhe të drejtat e saja
- Leximi dhe shkrimi
- Nxitja e saj të merr pjesë në ligjerata dhe tubime shkencore.
- Rregullat Islame (ahkam) në lidhje me gratë
- Blerja e librave islame dhe kasetave për bibliotekën e shtëpisë

#### 16. Xhelozia e mirë

- Sigurohuni të mbanë hixhab të përshtatshëm para se të del prej shtëpisë.

- Ndaloni përzierjen me meshkujt jo-mahrem.

- Largohuni prej xhelozisë së tepruar. Shembuj të kësaj janë:

1 – Duke analizuar secilën fjalë dhe fjali që ajo e thotë duke i mbingarkuar fjalët e saja me kuptime të cilat ajo nuk i ka menduar.

2 – Duke ja ndaluar asaj që të del prej shtëpisë kur arësytet për këtë janë të drejta.

3 – Duke ja ndaluar që t'i përgjigjet telefonit, etj. . .

#### 17. Durimi dhe butësia

- Problemet priten në çdo martesë prandaj kjo është gjë normale. Ajo që është e gabuar janë reagimet e tepërta dhe zmadhimi i problemeve deri sa të vjen në prishjen e martesës.

- Zemërimi duhet të tregohet vetëm atëherë kur ajo i tejkalon të gjitha kufijtë e All-llahut [subhanehu ve teal], duke i vonuar namazet, përgojim, duke shiquar gjëra të ndaluara në TV, etj. . .

- Faljani gabimet që ajo i bën ndaj juve (shif numër 18).

- Si mund që më së miri të ja përmirësoni gabimet e saja?

1 – Sëpari, me këshilla që nënkuptohen dhe të qarta, disa here me rradhë.

2 – Mandej duke ja këthyer shpinën asaj në krevat (duke i shprehur ndjenjat tuaja). Vëreni se kjo nuk don të thotë që ta leni dhomën e fjetjes në një dhomë tjetër, duke e braktisur shtëpinë për ndonjë vend tjetër, ose të mos bisedohet me te.

3 – Zgjedhja e fundit është që lehtë t'i mëshohet asaj (atëherë kur lejohet). Në këtë rast burri duhet të konsideron këtë që vijon:

- Ai duhet të din se është sunnet që t'i largohet rrahjes sikur që edhe i Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem) ka bërë, duke mos rrahur asnjëherë ndonjë grua të tij ose rob.

- Ai këtë duhet ta bën vetëm në raste ekstreme të mosdëgjueshmërisë, p.sh. duke refuzuar shpeshëherë pa arsye pasjen e marrëdhënieve seksuale, në mënyrë konstante duke mos u falur në kohë, duke e braktisur shtëpinë për periudha të gjata të kohës pa leje dhe refuzimi t'i tregon atij se ku ka qenë, etj. . .

- Nuk duhet të bëhet përveç pasi është larguar nga krevati dhe pasi që është diskutuar biseda me të siç është përmendur në Kur'an

- Ai nuk duhet ti mëshon fuqishëm me qëllim që ta dëmton, t'i

#### Klubi studentor

mëshon në fytyrë ose në pjesët tjera të ndjeshme të trupit.

- Ai nuk duhet ta turpëron siç është rasti me rrahjen me këpuçë etj.

#### 18. Falja dhe dënimi i përshtatshëm

- Mbajtja llogari vetëm për gabimet më të mëdhaja.

- Faljani gabimet që janë bërë në drejtim të tij (burrit), por mbani llogari për gabimet e bëra në drejtim të All-llahut [subhanehu ve teal] p.sh. vonimi i namazit, etj. . .

- Përkujtojani vetes të gjitha të mirat që ajo i bën sa herë që të bën ndonjë gabim.

- Mbani mend se të gjithë njerëzit gabojnë prandaj mundohuni të gjeni arsye për te, siç mund të jetë rasti se ajo është e lodhur, e pikëlluar, e ka ciklin e saj mujor ose se përkushtimi i saj ndaj Islamit është në rritje.

- Shmanguni sulmeve ndaj saj për shkak të ushqimit të keq pasi që i Dërguari [sal-lall-llahu alejhi ve selem] asnjëherë nuk ka fajësuar asnjë prej grave të tija për këtë. Nëse e pëlqen ushqimin, ai han, dhe nëse nuk e pëlqen atëherë ai nuk han dhe nuk komenton.

- Para se të deklaron se ajo është në gabim, tentoni pririje tjera indirekte të cilat janë më të lehta sesa akuzimet direkte.

- Largohuni prej përdorimit të ofendimeve dhe fjalë të cilat dëmtojnë ndjenjat e saja.

- Atëherë kur bëhet e nevojshme të diskutohet ndonjë problem pritni që të keni vetmi prej të tjerëve.

- Të pritni derisa zemërimi të bien pak mund të ndihmon që të mbani kontrollin e fjalëve tuaja.

Shejh Muhammed Abdul-Halim Hamid

Pasi të lexoni këtë broshurë, mundësojani të tjerëve të lexojnë të njëjtën. Dhe keni kujdes, fletushka përmban ajete kur'anore, andaj ndalohet hyrja me të në vende të ndotura, gjejësisht në toalet si dhe në vende të ngjashme.

Boton:

Shoqata Qytetare

Klubi Studentor

Rr. Stiv Naumov 7 / 18

Tel. ++389 (02) 32 23-654

1000, Shkup



**Si ta bëni  
gruan tuaj  
të lumtur**